



KOMUNIKATË PER SHTYPI

TRAFIK NDËRKOMBËTAR NARKOTIKËSH, KORRUPSION DHE PASTRIM PARASH.

D.I.A. DHE SPAK, NË KUADRIN E NJË SKUADRE TË PËRBASHKËT HETIMORE, FILLOJNE ZBATIMIN E 38 ARRESTIMEVE NË SHQIPËRI, ITALI, MALI I ZI DHE SPANJË, SI DHE SEKUESTRIMIVE PREJ DISA MILION EUROSH

Autoritetet Shqiptare dhe Drejtoria e Antimafia-s së Barit, me ndihmën e Zyrës Ndërlidhëse të Forcave të Përbashkëta të Tiranës dhe të Policisë Shqiptare, Agjensite e tjera ligjzbatuese, në kuadër të një **Skuadre të Përbashkët Hetimore, po zbatojnë në Shqipëri dhe në Itali, me vendim** të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Tiranë, e të DDA-së të Barit, – me koordimin e Eurojust-it (Hage) – i **drejtuar nga antari kombëtar i palës italiane, një** vendim mase sigurie të dhënë nga Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilën ka urdhëruar arrestimin e 38 personave të konsideruar përgjegjës për korrupsion, shpërdorim detyre, pastrim parash e trafik ndërkombëtar të sasive të konsiderueshme të lëndëve narkotike. Po zbatohen gjithashtu **vendimet e sekuestrimit** për pasuri të luajtshme, te paluajtshme dhe aktivitete tregtare, ne vlerë **disa milion euro**.

Ekzekutimi i operacionit ndërkombëtar është bërë i mundur, sidomos, falë **Skuadrës së Përbashkët Hetimore**, mjet i kooperimit gjyqësor i krijuar mes D.D.A-së së Barit, **Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit e Krimit të Organizuar në Tiranë** dhe Eurojust-it (Organizëm që mbështet kooperimin gjyqësor dhe luftën kundër formave të rënda të kriminalitetit transnacional), i cili i ka dhënë mundësinë personelit të DIA-s së Barit dhe Autoriteteve Shqiptare, Prokurorisë së Posaçme dhe Policisë së Shtetit të zgjerojnë hetimet, duke u mbështetur në rolin thelbesor të koordimit të siguar nga Drejtoria Kombëtare e Antimafias e Anti-terrorizmit.

Masat e sigurisë janë dhënë nga Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në kuadër të Operacionit **SHPIRTI**, në lidhje me hetimet e bëra nga muaji Maj 2019 deri në Janar 2021, që kanë bërë të mundur të mblidhen të dhëna të rëndësishme ndaj 38 shtetasve shqiptar, **pjestar të katër grupeve të fuqishme kriminale të organizuara**, vepruese nga viti 2014 deri në vitin 2017, në Shqipëri dhe në kontakt me organizatat kriminale bareze, në gjëndje të dërgonin në Evropë – duke zbarkuar në Puglia – sasi të konsiderueshme lëndë narkotike.

Autoritetet Shqiptare dhe DIA, gjatë hetimeve të mëparëshme bërë në Shqipëri në kuadër të operacioneve SHEFI dhe KULMI në mars të vitit 2018 e në qershor të vitit 2020, kanë rindërtuar, edhe me ndihmën e deklaratave të katër ***bashkëpunorëve të drejtësisë***, të dhëna për shkelje të ligjit dhe veprime korruptive të kryera nga zyrtar publik shqiptar, pastrim parash, po ashtu të gjithë ***“zinxhirin e prodhimit”*** të lëndës narkotike, që nga kultivimi, prodhimi, mbledhja, magazinimi dhe trafikimi në drejtim të brigjeve pugliese me mjete lundruese të fuqishme.

Një e re absolute e këtij hetimi është kontributi i çmuar i bashkëpunorëve të drejtësisë, të gjithë shtetas shqiptar, deklaratat e të cileve, në lidhje me krimet e kryera në Shqipëri dhe në Itali, janë mbledhur në Bari nga prokurorët e D.D.A-së lokale e të SPAK-ut të Tiranës e pasi janë verifikuar përkatësisht, janë përdorur – në kuadër të Skuadrës së përbashkët Hetimore – në procedimin penal shqiptar.

Masat e sigurisë të dhëna nga Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të zbatuara në Shqipëri, Itali, Mali i Zi dhe Spanjë, plotësojnë kuadrin hetimor – të pasurive e masave të sigurimit personal – të bëra në Shqipëri nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar edhe në lidhje me fenomenet e korrupsionit e shpërdorimit të detyrës që i përkasin zyrtarëve publik - kryesisht pjestar të forcave të policisë shqiptare – të cilët kanë garantuar që ***“zinxhiri i prodhimit”*** të lëndës narkotike të mos ndëpritej kurrë.

Në veçanti, masat e sigurisë personale janë ekzekutuar, (përveç 10 shtetasve që janë arrestuar më parë në kuadër të operacionit Kulmi) edhe për **një administrator publik (drejtor), një prokuror, tre zyrtar të lartë të policisë e dy punonjës të tjere policie, këta dy të fundit në kohën e kryerjes së veprave penale – në vitin 2016 - me detyrën e pjestarëve të grupit të shoqerimit të ish - Ministrit të Brendshëm.**

Zyrtarët publik, në disa raste pronarë të drogës, kanë garantuar, jo vetëm nga ana tokësore, por edhe detare në Shqipëri, që dërgimi i lëndës narkotike i destinuar në brigjet e Puglia-s të kryhej me siguri të plotë.

Masat parandaluese të pasurive dhe konkretisht sekuestro preventive që i përkasin sekuestrimit të pasurive të luajtëshme dhe të paluajtëshme, si apartamente, troje, restorante, njësi tregtare, **(12 pasuri të paluajtëshme), 4 (kater) shoqeri tregtare bashke me asetet e tyre** dhe disa automjete, të cilat arrijnë në vlerën e **disa miliona euro.**

Operacionet Shefi e Kulmi, gjithmonë të kryera në Itali e në Shqipëri në kuadër të Skuadrës së përbashkët hetimore, të përfundura – në dy momente – nga DIA e Barit me ekzekutimin e përgjithshëm të **80 masave të sigurisë** dhe sekuestrimet e pasurive për një vlerë prej **4 milion eurosh**, kishin bërë të mundur, ndër të tjera, në vitin 2016 të arrestoheshin ***“në det”*** në Polignano ***dy skafistet*** me prejardhje nga Shqipëria me shumë se një ton lëndë narkotike; të ndalohej në Bari Carrassi një korier italian me furgon me më shumë se një mijë kilogram lëndë narkotike e trafikuar më parë në Torre e Mare nga Shqipëria; të identifikoheshin në autostradë në Grottaminarda e në Vasto ***dy korieret*** italian ndërkohë që po transportonin lëndë narkotike e destinuar në Salerno e në Tortoreto (Te); të arrestoheshin ***dy korieret*** shqiptar me

lëndë narkotike në Sicili (Rg) pasi kishte zbritur nga një autobuz me prejardhje nga Bari; të identifikohesh një tjetër depo në Mola të Barit brenda të cilës janë gjetur dhe sekuestruar lende narkotike e llojit cannabis sativa bashkë me një pako me kokainë; të kapeshin në fragrance “në det” në Molfetta (Ba) dy skafistë nga Shqipëria me më shumë se **një ton lende narkotike**; të identifikohesh dhe sekuestrohesh në Savalletri (Br) një depozitë brënda të cilës ishin të ruajtura rreth **700 kg lëndë narkotike** e të njëjtit tip (përveç fishekëve për Kallashnikov, njësi kontrolli elektronike për automjete, dokumenta, kapuçë e gozhda prej hekuri me tre maja); të gjendej në Palagiano (Ta) **një korier** që po transportonte lende narkotike e destinuar në tregun Lucan; të sekuestroheshin disa karta identiteti italiane të fallsifikuara në Shqipëri, në emer të qytetarëve puglies, të cilët nuk ishin në dijeni, të perdorura nga Shqiptarët për të shkuar në Evropën e Veriut.

Në tërësi, në kuadër të hetimeve të sipërpërmendura, janë sekuestruar rreth **6 (gjashtë) tonelata** lëndë narkotike të tipit marijunë, kokainë e hashish, duke i hequr organizatave kriminale të ardhura të vlerësuara në mbi **55 milion euro**, për një sasi totale prej rreth **14 milion dozash njëshe** që dalin nga shpërndarja me pakicë.

Personat e akuzuar në operacioni *Shefi* janë dënuar, në shkallë të parë e të dytë, për vepra penale të ndryshme, e dënime deri në 20 vjet burg ndërsa, në lidhje me operacionin Kulmi, me datën 29 qershor 2021, Gj.S.P pranë Gjykatës së Barit ka dhënë një vendim të parë denimi ndaj **16 të pandehurve** të dënuar, për vepra penale të ndryshme, me dënime deri në **13 vjet burg**.

Masat e sigurisë të zbatuara në ditën e sotme - në burg (25) persona e në arreste shtëpie (3) persona - janë kryer në Shqipëri në qytetet e Vlorës, Kavajës, Durrësit e Tiranës, Skrapar. Në **Itali, Mali i Zi, e në Spanjë** .

Tiranë – Romë - Hage - Bari - 2 korrik 2020